



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK



## PLAFTORMA E PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EUROPIAN & KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

**Situata e Kapitullit 5 në procesin e negociatave: Përmbushja e piketave mbyllëse**

**E premte, 27 shkurt 2026, 10:00 – 12:00**

**Xheko Imperial Hotel**

**Agjencia e Prokurimit Publik dhe Lëvizja Europiane në Shqipëri** kanë kënaqësinë t'ju ftojnë në këtë Tryezë Diskutimi dhe Këshillimi për **Kapitullin 5 – Prokurimi Publik** në kuadër të Platformës së Partneritetit për Integrimin Europian dhe Konventës Kombëtare për Integrimin Europian për këtë kapitull.

Hapja e negociatave për Grupkapitullin 1 – “Themeloret”, shënoi gjithashtu vendosjen e tri piketave të përkohshme mbyllëse për Kapitullin 5 – Prokurimi Publik, të cilat vendosin objektiva të qarta dhe të matshme për avancimin e mëtejshëm në këtë fushë kyçe. Këto piketa përfshijnë: (i) harmonizimin e plotë të legjislacionit shqiptar në të gjitha segmentet e prokurimit publik me legjislacionin e Bashkimit Europian dhe me dispozitat përkatëse të *acquis*-së; (ii) sigurimin e kapaciteteve të mjaftueshme administrative dhe institucionale në të gjitha nivelet e qeverisjes, si dhe marrjen e masave konkrete për të garantuar zbatimin efektiv dhe të qëndrueshëm të legjislacionit; dhe (iii) demonstrimin e një historiku të besueshëm të funksionimit të një sistemi prokurimi publik të ndershëm, transparent dhe konkurrues, në përputhje me parimet themelore të barazisë, mosdiskriminimit, transparencës dhe eficiencës.

Kapitulli 5 konsiderohet ndër më të rëndësishmit në kuadër të “Themeloreve”, pasi lidhet drejtpërdrejt me mirëqeverisjen, luftën kundër korrupsionit, menaxhimin e financave publike dhe funksionimin e tregut të brendshëm. Për këtë arsye, progresi në këtë kapitull vlerësohet jo vetëm në aspektin formal të përafrimit ligjor, por edhe në rezultatet konkrete të arritura në praktikë. Në këtë tryezë do të trajtohet gjendja aktuale e Kapitullit 5 në kuadër të negociatave me BE-në, evidentimi i sfidave kryesore që hasen në procesin e harmonizimit dhe zbatimit, si dhe analizimin e pritshmërive për përmbushjen e piketave mbyllëse, ku në fokus do të jenë hapat konkrete që do të ndërmerren në vazhdim, pasi kërkohet angazhim i koordinuar institucional, qasje e qëndrueshme reformuese dhe monitorim i vazhdueshëm i rezultateve, me qëllim garantimin e një sistemi prokurimi publik që përmbush standardet europiane dhe forcon besimin e publikut.

Kjo tryezë synon të shërbejë si një hapësirë diskutimi me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të sektorëve të ndryshëm. Ju ftojmë të konfirmoni pjesëmarrjen tuaj në adresen [info@app.gov.al](mailto:info@app.gov.al) dhe [info@em-al.org](mailto:info@em-al.org)

\*Tryezat e Diskutimit dhe Këshillimit për Kapitullin 5 organizohen në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.113, datë 30.08.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Europian”.

\*Kjo tryezë zhvillohet në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritit Europian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK



## AGJENDA

### SITUATA E KAPITULLIT 5 NË PROCESIN E NEGOCIATAVE: PËRMBUSHJA E PIKETAVE MBYLLËSE

E premte, 27 shkurt 2026, 10:00 – 12:00

Xheko Imperial Hotel

**09:45 – 10:00**      **REGJISTRIMI I PJESËMARRËSVE DHE KAFE E MIRËSEARDHJES**

**10:00 – 10:20**      **FJALA PREZANTUESE**

**Reida Kashta**, Drejtore e Përgjithshme, Agjencia e Prokurimit Publik/**Xhoana Ristani**, Drejtor i Drejtorisë së Zbatimit të Politikave Strategjike dhe Integritimit, Agjencia e Prokurimit Publik

**Gledis Gjipali**, Drejtor Ekzekutiv, Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)

**10:20– 10:45**      **PREZANTIM I SITUATËS SË PËRGJITHSHME TË KAPITULLIT 5**

**Xhoana Ristani**, Drejtor i Drejtorisë së Zbatimit të Politikave Strategjike dhe Integritimit, Agjencia e Prokurimit Publik

**10:45 - 11:00**      **PËRMBUSHJA E PIKETAVE TË PËRKOHSHME MBYLLËSE PËR  
KAPITULLIN 5**

**Geri Pilaca**, Përgjegjës, Sektori i Integritimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Drejtoria e Zbatimit të Politikave Strategjike dhe Integritimit, Agjencia e Prokurimit Publik

**11:00 – 11:30**      **DISKUTIME ME PJESËMARRËSIT**

**12:00**              **MBYLLJA E AKTIVITETIT DHE KOKTEJL**

\*Tryezat e Diskutimit dhe Këshillimit për Kapitullin 5 organizohen në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.113, datë 30.08.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian”.

\*Kjo tryezë zhvillohet në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).